FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.37 | 20 prill | 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 35/2012 datë 29.3.2012	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Sistemin e Harmonizuar të Kodifikimit dhe Përshkrimit të Mallrave……	1729

LIGJ
Nr. 35/2012

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE PËR SISTEMIN E HARMONIZUAR TË KODIFIKIMIT DHE PËRSHKRIMIT TË MALLRAVE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën Ndërkombëtare për Sistemin e Harmonizuar të Kodifikimit dhe Përshkrimit të Mallrave.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 29.3.2012

Shpallur me dekretin nr. 7388, datë 10.4.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONVENTA NDËRKOMBËTARE
MBI SISTEMIN E HARMONIZUAR
(Bërë në Bruksel, më 14 qershor 1983)
(Amenduar sipas protokollit të amendimit të Konventës Ndërkombëtare të Sistemit të Harmonizuar të Përshkrimit të Mallrave dhe Sistemit të Kodifikimit, më 24 qershor 1986)

HYRJE

Palët kontraktuese në këtë Konventë, themeluar nën kujdesin e Këshillit të Bashkëpunimit Doganor,

me dëshirën për të lehtësuar tregtinë ndërkombëtare;

me dëshirën për të lehtësuar mbledhjen, krahasimin dhe analizën e statistikave, në veçanti ato mbi tregtinë ndërkombëtare;

me dëshirën për të zvogëluar shpenzimet që rrjedhin nga ripërshkrimi, riklasifikimi dhe rikodimi i mallrave kur ato lëvizin nga një sistem klasifikimi në një tjetër në rrjedhën e tregtisë ndërkombëtare dhe për të lehtësuar standardizimin e dokumentacionit tregtar dhe transmetimin e të dhënave;

duke pasur parasysh se ndryshimet në teknologji dhe modelet e tregtisë ndërkombëtare kërkojnë modifikime të shumta në Konventën mbi Nomenklaturën për Klasifikimin e Mallrave në Tarifat Doganore, bërë në Bruksel, më 15 dhjetor 1950;

duke pasur parasysh, gjithashtu, se niveli i të dhënave që kërkohen për qëllime doganore dhe qëllime statistikore nga qeveritë dhe interesat e tregtisë është rritur më shumë nga ajo që ofron nomenklatura e aneksuar në Konventën e lartpërmendur;

duke pasur parasysh rëndësinë e të dhënave të sakta dhe të krahasueshme për qëllimet e negociatave të tregtisë ndërkombëtare;

duke pasur parasysh se sistemi i harmonizuar ka për qëllim të përdoret për qëllime të tarifave të transportit të mallrave dhe statistikave të llojeve të ndryshme të transportit;

duke pasur parasysh se sistemi i harmonizuar synon të përfshihet në përshkrimin e mallrave tregtare dhe sistemin e kodimit sa më shumë që të jetë e mundur;

duke pasur parasysh se sistemi i harmonizuar synon të nxisë një lidhje më të afërt të mundshme midis statistikave të tregtisë në import dhe eksport dhe statistikave prodhuese;

duke pasur parasysh se një lidhje e afërt duhet të mbahet midis sistemit të harmonizuar dhe klasifikimit standard ndërkombëtar të tregtisë (SITC) të Shteteve të Bashkuara;

duke pasur parasysh dëshirën e plotësimit të nevojave të lartpërmendura nëpërmjet nomenklaturës tarifore/statistikore, të përshtatshme për t'u përdorur nga interesat e ndryshme lidhur me tregtinë ndërkombëtare;

duke pasur parasysh rëndësinë e mbajtjes së sistemit të harmonizuar të përditësuar me ndryshimet e teknologjisë apo modelet e tregtisë ndërkombëtare;

duke pasur parasysh punën e bërë në këtë fushë nga Komiteti i sistemit të harmonizuar të ngritur nga Këshilli i bashkëpunimit doganor;

duke pasur parasysh se ndërsa Konventa e sipërpërmendur e nomenklaturës është provuar si një instrument në arritjen e disa prej këtyre objektivave, mënyra më e mirë për të arritur rezultatet e dëshiruara në këtë drejtim është të nxirret një konventë ndërkombëtare e re;

kanë rënë dakord si më poshtë vijon,

Neni 1
Përkufizimet

Për qëllim të kësaj Konvente:

a) "Përshkrimi i mallrave të harmonizuara dhe sistemi i kodimit", më poshtë referuar si "sistemi i harmonizuar", do të thotë nomenklatura në të cilën përfshihen kapitujt, nënkapitujt dhe kodet numerike përkatëse të tyre, seksioni, kapitulli, shënimet e nënkapitujve dhe rregullat e përgjithshme për interpretimin e sistemit të harmonizuar, të përcaktuara në aneksin e kësaj Konvente.

b) "Nomenklatura e tarifës doganore" do të thotë nomenklatura e themeluar sipas legjislacionit të një pale kontraktuese për qëllimet e mbledhjes së detyrimeve doganore mbi mallrat e importuara.

c) "Nomenklaturë statistikore" do të thotë mallrat e nomenklaturës themeluar nga një palë kontraktuese për mbledhjen e të dhënave për statistikat e tregtisë së importit dhe eksportit.

d) "Nomenklaturë e kombinuar tarifore/statistikore" do të thotë një nomenklaturë, në të cilën janë integruar tarifat doganore dhe nomenklatura statistikore, të kërkuara sipas ligjit nga një palë kontraktuese për deklarimin e mallrave të importit.

e) "Konventa për themelimin e Këshillit" do të thotë Konventa e krijimit të Këshillit të bashkëpunimit doganor, bërë në Bruksel më 15 dhjetor 1950.

f) "Këshilli" do të thotë Këshilli i bashkëpunimit doganor të referuar në paragrafin "d" më lartë.

g) "Sekretari i përgjithshëm" nënkupton sekretarin e përgjithshëm të Këshillit.

h) Termi "ratifikimin" do të thotë ratifikim, pranim ose miratim.

Neni 2
Aneksi

Aneksi i kësaj Konvente formon një pjesë integrale të saj, dhe çdo referencë ndaj Konventës përfshin një referencë në aneks.

Neni 3
Detyrimet e palëve kontraktuese

1. Lidhur me përjashtimet e renditura në nenin 4:

a) Çdo palë kontraktuese merr përsipër, përveçse siç parashikohet në nënparagrafin "c" të këtij paragrafi që nga data në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në lidhje me të, tarifa doganore e saj dhe nomenklatura statistikore duhet të jenë në përputhje me sistemin e harmonizuar. Pra, ajo merr përsipër se, në lidhje me tarifat doganore dhe nomenklaturën statistikore:

i) do të përdorë të gjithë titujt dhe nëntitujt e sistemit të harmonizuar, pa shtesë ose modifikim, së bashku me kodet numerike përkatëse;

ii) se do të zbatojë rregullat e përgjithshme për interpretimin e sistemit të harmonizuar dhe të gjitha shënimet e seksionit, kapitullit dhe nënkapitullit dhe nuk do të modifikojnë qëllimin e seksionit, kapitullit, titullit apo nënkapitullit të sistemit të harmonizuar; dhe

iii) se do të ndjekë renditjen numerike të sistemit të harmonizuar;

b) Çdo palë kontraktuese i bën, gjithashtu, të ditura publikisht statistikat tregtare te importit dhe eksportit në pajtim me kodet gjashtëshifrore të sistemit të harmonizuar ose me nismën e palës kontraktuese, përtej atij niveli, në atë masë që publikimi të mos pengohet për arsye të jashtëzakonshme, të tilla si fshehtësia komerciale apo siguria kombëtare;

c) Asgjë në këtë nen nuk i kërkon një pale kontraktuese të përdore nënkapitujt e sistemit të harmonizuar në nomenklaturën e tarifës doganore me kusht që të përmbushë detyrimet e mësipërme në "a" "i", "a" "ii" dhe "a" " iii" në një nomenklaturë të kombinuar tarifore/statistikore.

2. Në përputhje me ndërmarrjet në paragrafin 1 (a) të këtij neni, çdo palë kontraktuese mund të bëjë ndryshime të tilla në tekst që mund të jenë të nevojshme për të bërë efikas sistemin e harmonizuar në ligjin e brendshëm.

3. Asgjë në këtë nen nuk ndalon një palë kontraktuese të krijojë, në tarifën doganore ose nomenklaturën statistikore, nënndarje të klasifikimit të mallrave përtej nivelit të sistemit të harmonizuar, me kusht që çdo nënndarje e tillë të shtohet dhe kodohet në një nivel përtej atij të kodit numerik gjashtëshifror të përcaktuar në aneksin e kësaj Konvente.

Neni 4
Aplikimi i pjesshëm nga vendet në zhvillim

1. Çdo vend në zhvillim, palë kontraktuese, mund të vonojë aplikimin e saj për disa ose të gjithë nënkapitujt e sistemit të harmonizuar për një periudhë të tillë sa mund të jetë e nevojshme, duke pasur parasysh modelin e saj të tregtisë ndërkombëtare ose burimeve të saj administrative.

2. Një vend në zhvillim, palë kontraktuese, që zgjedh të aplikojë sistemin e harmonizuar pjesërisht, sipas dispozitave të këtij neni pranon të bëjë përpjekjet e saj më të mira drejt zbatimit të sistemit të harmonizuar të plotë gjashtëshifror, brenda pesë vjetëve nga data në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në lidhje me atë apo brenda një periudhe të tillë më tej siç mund ta konsiderojë të nevojshme, duke marrë parasysh dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

3. Një vend në zhvillim, palë kontraktuese, që zgjedh të aplikojë sistemin e harmonizuar pjesërisht sipas dispozitave të këtij neni zbaton të gjitha ose asnjë nga nënkapitujt me dy viza të çdo

njërit nënkapitull me një vizë ose të gjithë ose asnjë nënkapitull me një vizë të ndonjë kapitulli. Në raste të tilla të aplikimit të pjesshëm, shifra e gjashtë apo e pestë dhe e gjashtë e asaj pjese të kodit të sistemit të harmonizuar që nuk zbatohet duhet të zëvendësohet përkatësisht me "0" ose "00".

4. Një vend në zhvillim që zgjedh të zbatojë sistemin e harmonizuar pjesërisht në bazë të dispozitave të këtij neni në momentin e bërjes palë kontraktuese, njofton sekretarin e përgjithshëm për ato nënkapituj që ajo nuk do të zbatojë në datën kur kjo Konventë hyn në fuqi në lidhje me të dhe do të njoftojë, gjithashtu, sekretarin e përgjithshëm për ato nënkapituj të cilët zbatohen pas kësaj.

5. Çdo vend në zhvillim që zgjedh të zbatojë sistemin e harmonizuar pjesërisht sipas dispozitave të këtij neni, në momentin e bërjes palë kontraktuese mund të njoftojë sekretarin e përgjithshëm se ai formalisht angazhohet për zbatimin e sistemit të harmonizuar të plotë gjashtëshifrorit brenda tre vjetëve nga data kur kjo Konventë hyn në fuqi në lidhje me të.

6. Çdo vend në zhvillim palë kontraktuese, e cila pjesërisht zbaton sistemin e harmonizuar sipas dispozitave të këtij neni lirohet nga detyrimet e saj sipas nenit 3 në lidhje me nënkapitujt që nuk zbatohen.

Neni 5
Ndihmë teknike për vendet në zhvillim

Vendet e zhvilluara palë kontraktuese do të japin për vendet në zhvillim që kërkojnë ndihmë teknike mbi kushtet e rëna dakord bashkërisht në lidhje me, ndër të tjera, trajnimin e personelit, zhvendosjen e nomenklaturës së tyre ekzistuese në sistemin e harmonizuar dhe këshilla për mbajtjen e sistemeve të tyre të zhvendosura në mënyrë të përditësuar me ndryshimet e sistemit të harmonizuar, ose zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente.

Neni 6
Komiteti i Sistemit të Harmonizuar

1. Sipas kësaj Konvente do të themelohet një komitet që do të njihet si Komiteti i sistemit të harmonizuar, i përbërë nga përfaqësues prej secilës palë kontraktuese.

2. Ai do të mblidhet normalisht të paktën dy herë në vit.

3. Mbledhjet e tij do të thirren nga sekretari i përgjithshëm dhe, përveç kur palët kontraktuese vendosin ndryshe, do të mbahen në selinë e Këshillit.

4. Në Komitetin e sistemit të harmonizuar secila palë kontraktuese ka të drejtën e një vote, megjithatë, për qëllimet e kësaj Konvente dhe pa paragjykuar ndonjë konventë në të ardhmen, në të cilën një bashkim doganor ose ekonomik sikurse dhe kur një ose më shumë nga shtetet e tij anëtare janë palë kontraktuese, të tilla palë kontraktuese do të ushtrojnë së bashku vetëm një votë. Në mënyrë të ngjashme, në rastin kur të gjitha shtetet anëtare të bashkimit doganor ose ekonomik, të cilat kanë të drejtë të bëhen një palë kontraktuese sipas dispozitave të nenit 11 (b) bëhen palë kontraktuese, ato së bashku do të ushtrojnë vetëm një votë.

5. Komiteti i sistemit të harmonizuar zgjedh kryetarin e tij dhe një ose më shumë zëvendëskryetarë.

6. Ai harton rregulloren e vet të procedurës me vendim që merret nga jo më pak se dy të tretat e votave që u atribuohen anëtarëve të tij. Rregullat e procedurës të hartuara në këtë mënyrë do të miratohen nga Këshilli.

7. Ai fton organizata ndërqeveritare apo të tjera ndërkombëtare siç mund t'i konsiderojë të përshtatshme për të marrë pjesë si vëzhgues në punën e tij.

8. Ai ngre nënkomitete ose palët e punës sipas nevojës, duke pasur parasysh veçanërisht dispozitat e paragrafit 1 (a) të nenit 7, dhe përcakton anëtarësimin, të drejtat e votimit dhe rregullat e procedurës për nënkomitete të tilla ose palët e punës.

Neni 7
Funksionet e Komitetit

1. Komiteti i sistemit të harmonizuar, në përputhje me dispozitat e nenit 8, ka funksionet e mëposhtme:

a) të propozojë amendamente të tilla në këtë Konventë që mund të konsiderohen si të dëshirueshme, duke pasur parasysh, në veçanti, nevojat e përdoruesve dhe ndryshimet në teknologji ose në modelet e tregtisë ndërkombëtare;

b) të përgatisë shënime sqaruese, opinione klasifikuese apo këshilla të tjera si udhërrëfyes për interpretimin e sistemit të harmonizuar;

c) të përgatisë rekomandime për të siguruar njëtrajtshmëri në interpretimin dhe zbatimin e sistemit të harmonizuar;

d) të sistemojë dhe qarkullojë informacionin që lidhet me zbatimin e sistemit të harmonizuar;

e) me iniciativën e vet ose me kërkesë që të sigurojë informata ose udhëzime mbi çdo çështje në lidhje me klasifikimin e mallrave në sistemin e harmonizuar për palët kontraktuese, për anëtarët e Këshillit dhe organizata të tilla ndërqeveritare apo të tjera ndërkombëtare që komisioni mund t'i konsiderojë të përshtatshme;

f) të paraqesë raporte për çdo seancë të Këshillit në lidhje me aktivitetet e tij, duke përfshirë amendamentet e propozuara, shënimet shpjeguese, opinionet klasifikuese dhe këshilla të tjera;

g) të ushtrojë kompetenca dhe funksione të tjera në lidhje me sistemin e harmonizuar sipas nevojave të Këshillit ose palëve kontraktuese.

2. vendimet administrative të Komitetit të sistemit të harmonizuar që kanë të bëjnë me buxhetin do të jenë subjekt i miratimit nga Këshilli.

Neni 8
Roli i Këshillit

1. Këshilli shqyrton propozimet për ndryshimin e kësaj Konvente, të përgatitur nga Komiteti i sistemit të harmonizuar, dhe ua rekomandon palëve kontraktuese sipas procedurës së nenit 16, përveç rastit kur një anëtar i Këshillit, i cili është një palë kontraktuese në këtë Konventë kërkon që propozimet ose ndonjë pjesë e saj t'i referohen Komitetit për rishqyrtim.

2. Shënimet sqaruese, opinionet e klasifikimit, këshilla të tjera për interpretimin e sistemit të harmonizuar dhe rekomandime për të siguruar njëtrajtshmëri në interpretimin dhe zbatimin e sistemit të harmonizuar, të përgatitur gjatë një sesioni të Komitetit të sistemit të harmonizuar në bazë të dispozitave të paragrafit 1 të nenit 7, konsiderohen si të miratuara nga Këshilli, në qoftë se, jo më vonë se në fund të muajit të dytë që pason muajin gjatë të cilit është mbyllur sesioni, asnjë palë kontraktuese në këtë Konventë nuk ka njoftuar sekretarin e përgjithshëm se ajo kërkon që çështje të tilla t'i referohen Këshillit.

3. Kur një çështje i është referuar Këshillit në bazë të dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni, Këshilli miraton shënime të tilla sqaruese, opinione klasifikimi, këshilla apo rekomandime të tjera, përveç rastit kur ndonjë anëtar i Këshillit, i cili është palë kontraktuese në këtë Konventë kërkon që ato t'i referohen plotësisht ose pjesërisht Komitetit për rishqyrtim.

Neni 9
Normat e taksës doganore

Palët kontraktuese nuk marrin përsipër nga kjo Konventë ndonjë detyrim në lidhje me normat e taksës doganore.

Neni 10
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje midis palëve kontraktuese, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, për aq sa është e mundur, do të zgjidhet me negociata midis tyre.

2. Çdo mosmarrëveshje që nuk është zgjidhur do t'i dërgohet nga palët në mosmarrëveshje Komitetit të sistemit të harmonizuar, i cili pas kësaj do të shqyrtojë mosmarrëveshjen dhe do të bëjë rekomandime për zgjidhjen e saj.

3. Nëse Komiteti i sistemit të harmonizuar nuk mund të zgjidhë mosmarrëveshjen, ai do t'ia referojë çështjen Këshillit, i cili do të bëjë rekomandime në përputhje me nenin 3 (e) të Konventës për themelimin e Këshillit.

4. Palët në mosmarrëveshje mund të bien dakord paraprakisht për të pranuar rekomandimet e Komitetit ose Këshillit si të detyrueshme.

Neni 11
E drejta për t'u bërë palë kontraktuese

Sa më poshtë kanë të drejtë të bëhen palë kontraktuese në këtë Konventë:

a) Vendet anëtare të Këshillit;

b) Bashkimet doganore ose ekonomike tek të cilat është transferuar kompetenca për të hyrë në traktate në lidhje me disa ose të gjitha çështjet që rregullohen nga kjo Konventë, dhe çdo shtet tjetër të cilit i është drejtuar një ftesë për këtë qëllim nga sekretari i përgjithshëm në drejtimin e Këshillit.

Neni 12
Procedura për t'u bërë palë kontraktuese

1. Çdo shtet ose bashkim doganor ose ekonomik i pranueshëm mund të bëhet palë kontraktuese në këtë Konventë:

a) duke e nënshkruar atë pa rezerva për ratifikim;

b) duke depozituar një instrument ratifikimi, pasi ka nënshkruar Konventën subjekt për ratifikim; ose

c) duke aderuar në të pasi Konventa ka pushuar së qeni e hapur për nënshkrim.

2. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim deri më 31 dhjetor 1986, në selinë e Këshillit në Bruksel nga shtetet dhe bashkimet doganore ose ekonomike të përmendura në nenin 11. Pas kësaj, ajo do të jetë e hapur për pranimin e tyre.

3. Instrumentet e ratifikimit ose të pranimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 13
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi ditën më të parë të 1 janarit që bie të paktën tre muaj pasi minimumi shtatëmbëdhjetë shtete ose bashkime doganore apo ekonomike të referuara në nenin 11 më lart e kanë nënshkruar atë për ratifikim pa rezervë ose kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose pranimit, por jo para 1 janarit 1988.

2. Për çdo shtet ose bashkim doganor ose ekonomik që e ka nënshkruar për ratifikim pa rezervë ose qe aderon në këtë Konventë pas përmbushjes së numrit minimal të specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni, kjo Konventë hyn në fuqi në 1 janar që bie të paktën dymbëdhjetë muaj, por jo më shumë se njëzet e katër muaj pasi ajo ka nënshkruar Konventën për ratifikim pa rezervë ose ka depozituar instrumentin e tij të ratifikimit ose aderimit, përveçse nëse ai përcakton një datë më të hershme. Megjithatë, data e hyrjes në fuqi sipas dispozitave të këtij paragrafi nuk do të jetë më herët se data e hyrjes në fuqi të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 14
Aplikimi nga territoret e varësisë

1. Çdo shtet, në kohën e bërjes palë kontraktuese në këtë Konventë, ose në çdo kohë pas kësaj, mund të deklarojë me anë të njoftimit të dhënë sekretarit të përgjithshëm që Konventa do të shtrihet në të gjitha ose ndonjë nga territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave ai është përgjegjës, të përmendur në njoftimin e tij. Ky njoftim hyn në fuqi në 1 janar që bie të paktën dymbëdhjetë muaj, por jo më shumë se njëzet e katër muaj pas datës së marrjes së tij nga sekretari i përgjithshëm, përveç rasteve kur një datë më e hershme është specifikuar në njoftim. Megjithatë, kjo Konventë nuk zbatohet për territore të tilla para se të ketë hyrë në fuqi në shtetin në fjalë.

2. Kjo Konventë pushon së pasuri fuqi për një territor të caktuar në datën kur pala kontraktuese, pushon së qeni përgjegjëse për marrëdhëniet ndërkombëtare të atij territori ose më parë se një datë e tillë siç mund t'i jetë njoftuar sekretarit të përgjithshëm sipas procedurës së nenit 15.

Neni 15
Denoncimi

Kjo Konventë ka një kohëzgjatje të pakufizuar. Megjithatë, çdo palë kontraktuese mund ta denoncojë atë dhe një denoncim i tillë hyn në fuqi një vit pas marrjes së instrumentit të denoncimit nga ana e sekretarit të përgjithshëm, përveç kur një datë e mëvonshme është specifikuar atje.

Neni 16
Procedura e amendimit

1. Këshilli mund të rekomandojë ndryshime të kësaj Konvente për palët kontraktuese.

2. Çdo palë kontraktuese mund të njoftojë sekretarin e përgjithshëm për një kundërshtim mbi një ndryshim të rekomanduar dhe më pas mund ta tërheqë këtë kundërshtim brenda periudhës së specifikuar në paragrafin 3 të këtij neni.

3. Çdo ndryshim i rekomanduar konsiderohet të jetë pranuar gjashtë muaj pas datës së njoftimit të tij nga sekretari i përgjithshëm me kusht që të mos ketë asnjë kundërshtim të pazgjidhur në fund të kësaj periudhe.

4. Ndryshimet e pranuara hyjnë në fuqi për të gjitha palët kontraktuese në një nga datat e mëposhtme:

a) kur ndryshimi i rekomanduar është njoftuar para datës 1 prill, do të jetë data e 1 janarit të vitit të dytë pas datës së një njoftimi të tillë; ose

b) kur ndryshimi i rekomanduar është njoftuar në ose pas 1 prillit, do të jetë data e 1 janarit të vitit të tretë pas datës së një njoftimi të tillë.

5. Nomenklatura statistikore e çdo palë kontraktuese dhe nomenklatura e tarifës doganore, ose, në rastin e parashikuar në paragrafin 1 (c) të nenit 3, nomenklatura e kombinuar tarifore/statistikore, do të paraqiten në pajtim me sistemin e harmonizuar të ndryshuar në datën e specifikuar në paragrafin 4 të këtij neni.

6. Çdo shtet ose bashkim doganor ose ekonomik që ka nënshkruar pa rezerva, ratifikimin ose aderimin në këtë Konventë konsiderohen se kanë pranuar çdo ndryshim, të cilat, në datën kur janë bërë një palë kontraktuese, kanë hyrë në fuqi ose janë pranuar në bazë të dispozitave te paragrafit 3 të këtij neni.

Neni 17

Të drejtat e palëve kontraktuese në lidhje me sistemin e harmonizuar

Në çdo çështje që ndikon në sistemin e harmonizuar, paragrafi 4 i nenit 6, nenit 8 dhe paragrafi 2 i nenit 16 do t'i japë të drejta një palë kontraktuese:

a) në lidhje me të gjitha pjesët e sistemit të harmonizuar të cilat zbatohen sipas dispozitave të kësaj Konvente, ose

b) deri në datën kur kjo Konventë hyn në fuqi në lidhje me të në përputhje me dispozitat e nenit 13, në lidhje me të gjitha pjesët e sistemit të harmonizuar për të cilat është e detyruar t'i zbatojë në atë datë sipas dispozitave të kësaj Konvente; ose

c) në lidhje me të gjitha pjesët e sistemit të harmonizuar, me kusht që të ketë marrë përsipër zyrtarisht zbatimin e sistemit të harmonizuar të plotë gjashtëshifror brenda periudhës së tri viteve të referuara në paragrafin 5 të nenit 4 dhe deri në mbarimin e kësaj periudhe.

Neni 18

Rezerva

Asnjë rezervë nuk do të lejohet për këtë Konvente.

Neni 19

Njoftimet nga sekretari i përgjithshëm

Sekretari i përgjithshëm njofton palët kontraktuese, shtetet e tjera nënshkruese, shtetet anëtare të Këshillit që nuk janë palë kontraktuese në këtë Konventë, dhe sekretarin e përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, për sa vijon:

a) Njoftimet sipas nenit 4;

b) Nënshkrimet, ratifikimet dhe pranimet siç referohen në nenin 12;

c) Datën në të cilën Konventa hyn në fuqi në përputhje me nenin 13;

d) Njoftimet sipas nenit 14;

e) Denoncimet sipas nenit 15;

f) Ndryshimet e Konventës të rekomanduara sipas nenit 16;

g) Kundërshtimet në lidhje me ndryshimet e rekomanduara në bazë të nenit 16 dhe, kur është e përshtatshme, tërheqjen e tyre; dhe

h) Ndryshimet e pranuara sipas nenit 16, dhe datën e hyrjes së tyre në fuqi.

Neni 20
Regjistrimi me Kombet e Bashkuara

Kjo Konventë regjistrohet në sekretariatin e Kombeve të Bashkuara në përputhje me dispozitat e nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara me kërkesë të sekretarit të përgjithshëm të Këshillit.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë të autorizuar sipas rregullit, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Bruksel, në datën e 14 qershorit 1983 në gjuhët anglisht dhe frëngjisht, të dyja tekstet janë njëlloj autentike, në një kopje origjinale të vetme që do të depozitohet pranë sekretarit të përgjithshëm të Këshillit, i cili do t'i transmetojë kopje të vërtetuara të tij të gjitha shteteve dhe bashkimeve doganore ose ekonomike të referuara në nenin 11.

SEKSIONI I

KAFSHET E GJALLA; PRODUKTET ME ORIGJINE PREJ KAFSHEVE

Shenime.

1. Çdo reference ne kete Seksion per nje specie apo lloj te veçante kafshe, perveç kur konteksti e kerkon ndryshe, perfshin referencen e asaj specie apo kafshe ne moshe te re.

2. Veçse kur konteksti e kerkon ndryshe, gjate gjithe Nomenklatures çdo reference per produktet e **"thara"** perfshin gjithashtu produktet qe jane te dehidratuar, te avulluara apo te thara ne ngrice.

Kapitulli 1

Kafshet e gjalla

Shenim.

1. Ky Kapitull perfshin te gjitha kafshet e gjalla, perveç:

   (a) Peshkut dhe kafsheve guaskore qe jetojne nen uje, molusqeve dhe kafsheve te tjera jo vertebrore ujore, te kreut 03.01, 03.06 apo 03.07;

   (b) Kulturave e mikro-organizmave dhe produkteve te tjera te kreut 30.02; dhe

   (c) Kafsheve te kreut 95.08.

01.01		**Kuaj, gomere dhe mushka te gjalla:**
	0101.10	- Te races se paster per riprodhim
	0101.90	- Te tjera
01.02		**Gjedhe te gjalla:**
	0102.10	- Te races se paster per riprodhim
	0102.90	- Te tjera
01.03		**Derra te gjalle:**
	0103.10	- Kafshe te races se paster
		- Te tjera:
	0103.91	- - Qe peshojne me pak se 50 kg
	0103.92	- - Qe peshojne 50 kg ose me shume
01.04		**Dele dhe dhi te gjalla:**
	0104.10	- Dele
	0104.20	- Dhi
01.05		**Shpende te gjalle, domethene, shpendet e llojit Gallus domesticus, rosa, pata, gjela deti dhe shpende indie:**
		- Me peshe jo me shume se 185 g:
	0105.11	- - Shpende te llojit Gallus domesticus

	0105.12	- - Gjela dhe pula deti
	0105.19	- - Te tjera
		- Te tjera:
	0105.94	- - Shpende te llojit Gallus domesticus
	0105.99	- - Te tjera
01.06		**Te tjera kafshe te gjalla:**
		- Gjitaret:
	0106.11	- - Primatet
	0106.12	- - Balenat, delfinet dhe derrat e detit (gjitare te llojit cetacea); lopet e detit (gjitare te llojit sirenia)
	0106.19	- - Te tjera
	0106.20	- Zvarraniket (perfshire gjarperinjte dhe breshkat detare)
		- Shpendet:
	0106.31	- - Shpendet grabitqare
	0106.32	- - Psittaciformes (duke perfshire papagallet, papagall trupvogel, macaws dhe cockatoos)
	0106.39	- - Te tjera
	0106.90	- Te tjera

Kapitulli 2

Mishi dhe te brendshmet e ngrenshme te mishit

Shenim.

1. Ky Kapitull nuk perfshin:

   (a) Produktet e llojeve te pershkruar ne kreret 02.01 deri 02.08 apo 02.10, te papershtatshme per konsum njerezor;

   (b) Zorret, fshikezat apo stomaket e kafsheve (kreu 05.04) apo gjaku i kafsheve (kreu 05.11 apo 30.02); apo

   (c) Dhjamin prej kafsheve, perveç produkteve te kreut 02.09 (Kapitulli 15).

02.01		**Mishi i gjedheve, i fresket apo i ftohte:**
	0201.10	- Trup dhe gjysem trup
	0201.20	- Prerje te tjera me kocka ne te
	0201.30	- Prerje pa kocka
02.02		**Mishi i gjedheve, i ngrire:**
	0202.10	- Trup dhe gjysem trup
	0202.20	- Prerje te tjera me kocka ne te
	0202.30	- Prerje pa kocka
02.03		**Mishi i derrave, i fresket, i ftohte apo i ngrire:**
		- Te fresket apo te ftohur:
	0203.11	- - Trup dhe gjysem trup
	0203.12	- - Kofshe, shpatulla dhe prerje prej tyre, me kocka ne to
	0203.19	- - Te tjera
		- I ngrire:
	0203.21	- - Trup dhe gjysem trup
	0203.22	- - Kofshe, shpatulla dhe prerje prej tyre me kocka ne to
	0203.29	- - Te tjera
02.04		**Mishi i deleve apo dhive, i fresket, i ftohte apo i ngrire:**
	0204.10	- Trup dhe gjysem- trup i qingjave, i fresket apo i ftohte
		- Tjeter mish deleje, i fresket apo i ftohur:
	0204.21	- - Trupa dhe gjysem- trupa
	0204.22	- - Prerje te tjera me kocka ne to
	0204.23	- - Prerje pa kocka
	0204.30	- Trupa dhe gjysem- trupa te qingjave, te ngrira
		- Tjeter mish deleje, i ngrire:
	0204.41	- - Trupa dhe gjysem- trupa
	0204.42	- - Prerje te tjera me kocka ne to

	0204.43	- - Prerje pa kocka
	0204.50	- Mish dhie
02.05	0205.00	**Mish i kuajve, gomereve, mushkave apo hibridit te gomarices, i fresket, i ftohte apo i ngrire.**
02.06		**Te brendshmet e ngrenshme te gjedheve, derrave, deleve, dhive, kuajve, gomereve, mushkave apo hibridit te gomarices, te fresketa, te ftohta apo te ngrira:**
	0206.10	- Prej gjedheve, te fresketa apo te ftohta
		- Prej gjedheve, te ngrira:
	0206.21	- - Gjuhe
	0206.22	- - Melçi
	0206.29	- - Te tjera
	0206.30	- Prej derri, i fresket apo i ftohur
		- Prej derri, i ngrire:
	0206.41	- - Melçite
	0206.49	- - Te tjera
	0206.80	- Te tjera, te fresketa apo te ftohta
	0206.90	- Te tjera, te ngrira
02.07		**Mishi dhe te brendshmet e ngrënshme, te shpendeve te kreut 0105, te fresketa, te ftohta apo te ngrira:**
		- Prej shpendeve te llojit Gallus domesticus:
	0207.11	- - Jo te prere ne copa, te fresketa apo te ftohta
	0207.12	- - Jo te prere ne copa, te ngrira
	0207.13	- - Prerje dhe te brendshme, te fresketa apo te ftohta
	0207.14	- - Prerje dhe te brendshme, te ngrira
		- Prej gjelave te detit:
	0207.24	- - Jo te prere ne copa, te fresketa apo te ftohta
	0207.25	- - Jo te prere ne copa, te ngrira
	0207.26	- - Prerje dhe te brendshme, te fresketa apo te ftohta
	0207.27	- - Prerje dhe te brendshme, te ngrira
		- Prej patave, rosave apo shpendeve Indi:
	0207.32	- - Jo te prere ne copa, te fresketa apo te ftohta
	0207.33	- - Jo te prere ne copa, te ngrira
	0207.34	- - Melçi te dhjamura, te fresketa apo te ftohta
	0207.35	- - Te tjera, te fresketa apo te ftohta
	0207.36	- - Te tjera, te ngrira
02.08		**Mish tjeter dhe te brendeshmet e ngreneshme te tij, te fresketa, te ftohta apo te ngrira:**
	0208.10	- Te lepujve te bute apo te eger
	0208.30	- Te primateve
	0208.40	- Balenat, delfinet dhe derrat e detit (gjitare te llojit cetace); lopet e detit (gjitare te llojit sirena)

Seksioni
Kapitulli

	0208.50	- Te zvarranikeve (duke perfshire gjarperinte dhe breshkat)
	0208.90	- Te tjera
02.09	0209.00	**Dhjam derri, i cliruar prej shtresave te mishit, dhe dhjam shpendesh, jo i nxjerre me ane te shkrirjes apo jo i nxjerre ndryshe, i fresket, i ftohte, i ngrire, i kriposur, ne uje me kripe, i thare apo i tymosur.**
02.10		**Mishi dhe te brendeshmet e ngreneshme te mishit, te kriposura, ne uje me kripe, te thara apo te tymosura; puder e ngrenshme e mishit dhe e te brendeshmeve te mishit:**
		- Mish prej derri:
	0210.11	- - Kofshe, shpatulla dhe prerje prej tyre, me kocka ne to
	0210.12	- - Pjesa e barkut (me dhjam ne te) dhe prerje prej tyre
	0210.19	- - Te tjera
	0210.20	- Mish i gjedheve
		- Te tjera, perfshire miellra dhe pudra te ngrenshme prej mishi apo te brendshmeve te mishit:
	0210.91	- - Te primateve
	0210.92	- - Te balenave, delfineve dhe derrave te detit (gjitare te llojit cetace); lopeve te detit (gjitare te llojit sirena)
	0210.93	- - Te zvarranikeve (perfshire gjarperinjte dhe breshkat)
	0210.99	- - Te tjera

Kapitulli 3

Peshku dhe kafshet guackore te nenujshme, molusqet dhe kafshet e tjera jovertebrore ujore

Shenime.

1. Ky Kapitull nuk perfshin:

   (a) gjitaret e kreut 01.06;

   (b) mishin e gjitareve te kreut 01.06 (kreu 02.08 ose 02.10);

   (c) peshkun (perfshire melçite dhe vezet prej tyre) apo kafshet guaskore te nenujshme, molusqet dhe kafshet e tjera jo vertebrore ujore, te ngordhura dhe te papershtatshme per konsum njerezor per arsye si te llojit te tyre ose te gjendjes se tyre (Kapitulli 5); miellrat, sferat apo kokrrizat e peshkut apo te kafsheve guaskore te nenujshme, te molusqeve apo kafsheve te tjera jo vertebrore ujore, te papershtatshme per konsum njerezor (kreu 23.01); apo

   (d) Havjar apo zevendesuesit e havjarit pergatitur prej vezeve te peshkut (kreu 16.04).

2. Ne kete Kapitull termi "sfera" ka kuptimin e produkteve te cilat jane aglomeruar ose direkt nga shtypja ose direkt nga shtesa e nje sasie te vogel lidhesi.

03.01		**Peshk i gjalle:**
	0301.10	- Peshk zbukurimi
		- Te tjere peshq te gjalle:
	0301.91	- - Trofte (Salmo trutta, Oncorhynchus mykiss, Oncorhynchus clarki, Oncorhynchus aguabonita, Oncorhynchus gilae, Oncorhynchus apache dhe Oncorhynchus chrysogaster)
	0301.92	- - Ngjala (Anguilla spp)
	0301.93	- - Krap
	0301.94	- - Ton me flete notuese blu (Thunnus thynnus)
	0301.95	- - Ton me flete notuese blu, i jugut (Thunnus maccoyii)
	0301.99	- - Te tjera
03.02		**Peshk, i fresket apo i ftohte, perjashto filetot e peshkut dhe mish tjeter prej peshkut te kreut 0304:**
		- Salmoniade, perjashto melcite dhe vezet:
	0302.11	- - Trofte (Salmo trutta, Oncorhynchus mykiss, Oncorhynchus clarki,Oncorhynchus aguabonita, Oncorhynchus gilae, Oncorhynchus apache dhe Oncorhynchus chrysogaster)
	0302.12	- - Salmon i Paqesorit (Oncorhynchus nerka, Oncorhynchus gorbuscha,Oncorhynchus keta, Oncorhynchus tschawytscha, Oncorhynchuskisutch, Oncorhynchus masoudhe Oncorhynchus rhodurus), salmoni iAtlantikut (Salmo salar)dhe salmoni i Danubit (Hucho hucho)
	0302.19	- - Te tjera
		- Peshk i rrafshet (Pleuronectidae, Bothidae, Cynoglossidae, Soleidae,

		Scophthalmidae dhe Citharidae), perjashto melcite dhe vezet:
	0302.21	- - Rumbe deti (Reinhardtius hippoglossoides, Hippoglossus hippoglossus, Hippoglossus stenolepis)
	0302.22	- - Gjuhez (Pleuronectes platessa)
	0302.23	- - Sole (Solea spp)
	0302.29	- - Te tjera
		- Ton (te llojit Thunnus), bonito me bark vija- vija (Euthynnus (Katsuwonus) pelamis), perjashto melcite dhe vezet:
	0302.31	- - Ton i bardhe apo me flete notuese te gjate (Thunnus alalunga)
	0302.32	- - Ton me flete notuese te verdhe (Thunnus albacares)
	0302.33	- - Bonito me bark vija- vija
	0302.34	- - Ton symadh (Thunnus obesus)
	0302.35	- - Ton me flete notuese blu (Thunnus thunnus)
	0302.36	- - Ton me flete notuese blu, i jugut (Thunnus maccoyii)
	0302.39	- - Te tjera
	0302.40	- Harrenga (Clupea harengus, Clupea pallasii), perjashto melcite dhe vezet
	0302.50	- Merluc (Gadus morhua, Gadus ogac, Gadus macrocephalus), perjashto melcite dhe vezet
		- Peshk tjeter, perjashto melcite dhe vezet:
	0302.61	- - Sardele (Sardina pilchardus,Sardinops spp), sardinella(Sardinella spp), Brisling apo sprats (Sprattus sprattus)
	0302.62	- - Eglefin (Melanogrammus aeglefinus)
	0302.63	- - Peshk i zi (Pollachius virens)
	0302.64	- - Skumbri (Scomber scombrus, Scomber australascius, Scomber japonicus)
	0302.65	- - Peshkaqenet
	0302.66	- - Ngjala (Anguilla spp)
	0302.67	- - Peshk shpate (Xiphias gladius)
	0302.68	- - Toothfish (Dissostichus spp)
	0302.69	- - Te tjera
	0302.70	- Melcite dhe vezet
03.03		**Peshk, i ngrire, perjashto filetot e peshkut dhe mish tjeter prej peshkut te kreut 0304 :**
		- Salmon i Paqesorit (Oncorhynchus nerka, Oncorhynchus gorbuscha, Oncorhynchus keta, Oncorhynchus tschawytscha, Oncorhynchus kisutch, Oncorhynchus masou dhe Oncorhynchus rhodurus), perjashto melcite dhe vezet:
	0303.11	- - Salmon Sockey (Salmon i kuq) (Oncorhynchus nerka)
	0303.19	- - Te tjera
		- Salmonide te tjera, perjashto melcite dhe vezet:
	0303.21	- - Trofte (Salmo trutta, Oncorhynchus mykiss, Oncorhynchus clarki, Oncorhynchus aguabonita, Oncorhynchus gilae,Oncorhynchus apache dhe Oncorhynchus chrysogaster)
	0303.22	- - Salmoni i Atlantikut (Salmo salar) dhe Salmoni i Danubit (Hucho hucho)

	0303.29	- - Te tjera
		- Peshk i rrafshet (Pleuronectiade, Bothidae, Cynoglossidae, Soleidae, Scophthakmidae dhe Citharidae), perjashto melcite dhe vezet:
	0303.31	- - Rumbe deti (Reinhardtius hippoglossus, Hippoglossus hippoglossus, hippoglossus stenolepis)
	0303.32	- - Gjuhez (Pleuronectes platessa)
	0303.33	- - Sole (Solea spp)
	0303.39	- - Te tjera
		- Ton (i llojit Thunnus), bonito skipjack apo me bark vija- vija (Euthynnus (Katsuwonus) pelamis), perjashto melcite dhe vezet:
	0303.41	- - Ton i bardhe apo me flete notuese te gjate(Thunnus alalunga)
	0303.42	- - Ton me krahe te verdhe (Thunnus albacares)
	0303.43	- - Bonito skipjack apo me bark vija- vija
	0303.44	- - Ton symadh (Thunnus obesus)
	0303.45	- - Ton blu (Thunnus thunnus)
	0303.46	- - Ton blu i jugut (Thunnus maccoyii)
	0303.49	- - Te tjera
		- Harrenga (Clupea harengus, Clupea Pallasii), dhe merluc (Gadus morhua, Gadus ogac, Gadus macrocephalus), perjashto melcite dhe vezet:
	0303.51	- - Harrenga (Clupea harengus, Clupea Pallasii)
	0303.52	- - Merluc (Gadus morhua, Gadus ogac, Gadus macrocephalus)
		- Peshk shpate (Xiphias gladius) dhe Toothfish (Dissostichus spp):
	0303.61	- - Peshk shpate (Xiphias gladius)
	0303.62	- - Toothfish (Dissostichus spp)
		- Peshk tjeter, perjashto melcite dhe vezet:
	0303.71	- - Sardele (Sardina pilchardus, Sardinops spp), sardinella (Sardenella spp), bristling apo sprats (Sprattus sprattus)
	0303.72	- - Eglefin (Melanogrammus aeglefinus)
	0303.73	- - Peshk i Zi (Pollachius virens)
	0303.74	- - Skumri (Scomber scomburs, Scomber australasicus, Scomberjaponicus)
	0303.75	- - Peshkaqenet
	0303.76	- - Ngjala (Anguilla spp)
	0303.77	- - Levrek deti (Dicentrarchus labrax, Dicentrarchus punctatus)
	0303.78	- - Hake (Merluccius spp, Urophycis spp)
	0303.79	- - Te tjera
	0303.80	- Melcite dhe vezet
03.04		**Fileto peshku dhe mish tjeter peshku (nese eshte apo jo i grire), i fresket, i ftohte apo i ngrire:**
		- I fresket apo i ftohte:
	0304.11	- - Peshk shpate (Xiphias gladius)
	0304.12	- - Toothfish (Dissostichus spp)
	0304.19	- - Te tjera
		- Fileto te ngrira:

	0304.21	- - Peshk shpate (Xiphias gladius)
	0304.22	- - Toothfish (Dissostichus spp)
	0304.29	- - Te tjera
		- Te tjera:
	0304.91	- - Te peshkut shpate (Xiphias gladius)
	0304.92	- - Te Toothfish (Dissostichus spp)
	0304.99	- - Te tjera
03.05		**Peshk, i thare, i kripur apo ne uje me kripe; peshk i tymosur, nese eshte gatuar apo jo me pare apo gjate procesit te tymosjes; miellra, kokriza dhe sfera te peshkut, te pershtatshme per konsum njerezor:**
	0305.10	- Miell, kokriza dhe sfera te peshkut, te pershtatshme per konsum njerezor
	0305.20	- Melcite dhe vezet, te thara, tetymosura, te kripura apo ne uje me kripe
	0305.30	- Fileto peshku, te thara, te kripura apo ne uje me kripe, por jo te tymosura
		- Peshk i tymosur, perfshire filetot:
	0305.41	- - Salmon i Paqesorit (Oncorhynchus nerka, Oncorhynchus gorbuscha, Oncorhynchus keta, Oncorhynchus tschawytscha, Oncorhynchus kisutch, Oncorhynchus masou dhe Oncorhynchus rhodurus), salmoni i Atlantikut (Salmo salar) dhe salmoni i Danubit (Hucho hucho)
	0305.42	- - Harrenga (Clupea harengus, Clupea pallasii)
	0305.49	- - Te tjera
		- Peshk i thare, nese eshte apo jo i kripur, por jo i tymosur:
	0305.51	- - Merluc (Gadus morhua, Gadua ogac, Gadus macrocephalus)
	0305.59	- - Te tjera
		- Peshk, i kripur por jo i thare apo i tymosur dhe peshk ne uje me kripe:
	0305.61	- - Harrenga (Clupea harangus, Clupea pallasii)
	0305.62	- - Merluc (Gadus morhua, Gadus ogac, Gadus macrocephalus)
	0305.63	- - Açuget (Engraulis spp)
	0305.69	- - Te tjera
03.06		**Kafshet guackore te nenujshme, nese jane apo jo ne guacke, te gjalla, te fresketa, te ftohta, te ngrira, te thara, te kripura apo ne uje me kripe; kafshet guackore te nenujshme, ne guacke, te gatuar nga avulli apo nga zierja ne uje, nese jane apo jo te ftohta, te ngrira, te thara, te kripura apo ne uje me kripe;miellra, kokrriza dhe sfera te kafsheve guackore te nenujshme, te pershtatshme per konsum njerezor:**
		- I ngrire:
	0306.11	- - Gaforet e shkembinjeve dhe karavidhe te tjera deti (Palinurus spp, Panulirus spp, Jasus spp)
	0306.12	- - Gafore deti (Homarus spp)
	0306.13	- - Karkaleca deti
	0306.14	- - Gaforet
	0306.19	- - Te tjera, perfshire miellra, kokriza dhe sfera te kafsheve guackore te nenujshme, te pershtatshme per konsum njerezor
		- Jo te ngrira:

	0306.21	- - Gaforet e shkembinjeve dhe karavidhe te tjera deti (Palinurus spp, Panulirus spp, Jasus spp)
	0306.22	- - Gafore deti (Homarus spp)
	0306.23	- - Karkaleca deti
	0306.24	- - Gaforet
	0306.29	- - Te tjera, perfshire miellrat, kokrrizat dhe sferat e kafsheve guackore te nenujshme, te pershtatshme per konsum njerezor
03.07		**Molusqet, nese jane apo jo ne guacke, te gjalla, te fresketa, te ftohta, te ngrira, te thara, te kripura apo ne uje me kripe; kafshet jovertebrore ujore te tjera vec kafsheve guackore te nenujshme dhe molusqeve, te gjalla, te fresketa, te ftohta, te thara,te kripura apo ne uje me kripe; miellrat,kokrrizat dhe sferat e kafsheve jovertebrore ujore perveç kafsheve guackore te nenujshme, te pershtatshme per konsum njerezore:**
	0307.10	- Midhje (Oysters)
		- Goca deti, perfshire ato mbreteresha, te llojit Pecten, Chlamys apo Placopecten:
	0307.21	- - Te gjalla, te freket apo te ftohte
	0307.29	- - Te tjera
		- Midhje (Mytilus spp, Perna spp):
	0307.31	- - Te gjalla, te fresketa apo te ftohta
	0307.39	- - Te tjera
		- Sepje (Sepia officinalis, Rossia macrosoma, Sepiola spp) dhe squid (Ommastrephes spp, Loligo spp, Nototodarus spp, Sepioteuthis spp):
	0307.41	- - Te gjalla, te fresketa apo te ftohta
	0307.49	- - Te tjera
		- Oktapode (Octopus spp):
	0307.51	- - Te gjalla, te fresketa apo te ftohta
	0307.59	- - Te tjera
	0307.60	- Kermij, ndryshe nga kermijte e detit
		- Te tjera, perfshire miellrat, kokrizat dhe sferat e kafsheve jovertebrore ujore perveç kafsheve guackore te nenujshme, te pershtatshme per konsum njerezor:
	0307.91	- - Te gjalla, te fresketa apo te ftohta
	0307.99	- - Te tjera

KAPITULLI 4

PRODUKTET BULMETORE; VEZET E ZOGJVE; MJALTI NATYRAL; PRODUKTE TE NGRENSHME ME ORIGJINE PREJ KAFSHEVE, TE PAPERFSHIRA APO TE PASPECIFIKUARA DIKU TJETER

Shenime

1. Shprehja "qumesht" ka kuptimin e qumeshtit te paskremuar apo qumeshtit pjeserisht apo teresisht te skremuar.
2. Per qellimet e kreut 04.05:

   (a) Termi **"gjalpe"** nenkupton gjalpin natyral, gjalpin prej hirres apo gjalpin e rikombinuar (gjalpe i fresket, i kriposur apo i athet, perfshire gjalpin e konservuar) te rrjedhur ekskluzivisht nga qumeshti, me nje permbajtje yndyre qumeshti ndaj peshes prej 80% apo me shume por jo me teper se 95 %, me nje maksimum permbajtje ndaj peshes te elementeve te ngurte jo yndyrore prej 2 % dhe me nje maksimum permbajtje uji ndaj peshes prej 16 %. Gjalpi nuk permban emulsifikues shtese, por mund te permbaje klorur natriumi, ngjyrues ushqimore, kripera neutralizuese dhe kultura prej baktereve te pademshme qe prodhojne acid laktik;

   (b) Shprehja **"produkte qumeshti per tu shtruar"** ka kuptimin e nje emulsioni te shperndarshem te tipit uje ne yndyre, qe permban yndyre qumeshti si te vetmin yndyre ne produkt, me nje permbajtjeje yndyre qumeshti ndaj peshes prej 39 % apo me shume, por me pak se 80 %.

3. Produktet e fituara prej koncentrimit te hirres dhe me shtese te qumeshtit apo kremit te qumeshtit do te klasifikohen si djathe ne kreun 0406, me kusht qe ato te kene tre karakteristikat e meposhtme:

   (a) permbajtja e kremit te qumeshtit, ndaj peshes se lendes se thare, te jete 5 % apo me shume;
   (b) permbajtja e lendes se thate, ndaj peshes, te jete te pakten 70 % por jo me teper se 85 %; dhe
   (c) ato jane me forma apo ne gjendje te marrin forme.

4. Ky Kapitull nuk perfshin:

   (a) Produktet e fituara prej hirres, qe permbajne ndaj peshes me shume se 95 % laktoze, e shprehur si laktoze anhider e llogaritur mbi lenden e thate (kreu 17.02); apo
   (b) Albuminat (perfshire koncentratet e dy apo me shume proteinave te hirres, qe permbajne ndaj peshes me shume se 80 % proteina te hirres, te llogaritur mbi peshen e lendes se thate) (kreu 35.02) apo globulinat (kreu 35.04).

Shenime per nenkreret

1. Per qellimet e nenkreut 0404. 10, shprehja "hirre e modifikuar" ka kuptimin e produkteve qe perbehen nga perberesit e hirres, qe eshte, hirre nga e cila jane hequr teresisht apo pjeserisht laktoza, proteinat apo mineralet, hirre te ciles i jane shtuar perberesit natyrale te hirres dhe produktet e fituara nga perzierja e perberesve natyrale te hirres.
2. Per qellime te nenkreut 0405. 10 termi **"gjalpe"** nuk perfshin gjalpin e dehidratuar apo gjalpin e bere vete (nenkreu 0405. 90).

04.01		**Qumesht dhe krem, as i koncentruar as qe permban sheqer shtese apo ndonje lende tjeter embelsuese shtese:**
	0401.10	- Me nje permbajtje yndyre, ndaj peshes, jo me teper se 1 %
	0401.20	- Me nje permbajtje yndyre, ndaj peshes, me teper se 1% por jo me shume se 6 %

	0401.30	- Me nje permbajtje yndyre, ndaj peshes, me teper se 6%
04.02		**Qumesht dhe krem, i koncentruar apo qe permban sheqer shtese apo lende te tjera embelsuese:**
	0402.10	- Ne gjendje pudre, granulesh apo ne forma te tjera solide, te nje permbajtje yndyre, ndaj peshes, jo me teper se 15 %
		- Pluhur, kokrriza apo forma te tjera te ngurta, me permbajtje yndyre, ndaj peshes, qe e kalon 15%:
	0402.21	- - Qe nuk permban sheqer shtese apo lende te tjera embelsuese
	0402.29	- - Te tjera
		- Te tjera:
	0402.91	- - Qe nuk permban sheqer shtese apo lende te tjera embelsuese
	0402.99	- - Te tjera
04.03		**Dhalle, qumesht dhe krem i prere, kos, kefir dhe qumesht dhe krem tjeter te fermentuara apo te acidifikuara, nese jane apo jo te koncentruara apo qe permbajne sheqer shtese apo lende te tjera embelsuese apo lende aromatizuese apo qe permbajne fruta, arra apo kakao shtese:**
	0403.10	- Kos
	0403.90	- Te tjera
04.04		**Hirre, nese eshte apo jo e koncentruar apo qe permban sheqer shtese apo lende te tjera embelsuese; produktet qe perbehen nga perberes te qumeshtit natyral, nese permbajne apo jo sheqer shtese apo lende te tjera embelsuese, te paperfshira apo te paspecifikuara diku tjeter:**
	0404.10	- Hirre dhe hirre e modifikuar, nese eshte apo jo e koncentruar apo qe permban sheqer shtese apo lende te tjera embelsuese
	0404.90	- Te tjera
04.05		**Gjalpe, yndyrna dhe vajra te tjera te rrjedhura nga qumeshti; produkte qumeshti per tu shtruar (psh mbi buke, kek, etj):**
	0405.10	- Gjalpe
	0405.20	- Produkte te rrjedhura nga qumeshti per tu shtruar
	0405.90	- Te tjera
04.06		**Djathe dhe gjize:**
	0406.10	- Djathe i fresket (i papjekur apo i pastazhionuar) perfshire djathin prej hirres, dhe gjize
	0406.20	- Djath i grire apo i puderzuar, i te gjitha llojeve
	0406.30	- Djath i procesuar, jo i grire apo i puderzuar
	0406.40	- Djath me vena blu dhe djathra te tjere qe permbajne vena te prodhuar nga Penicillium roqueforti
	0406.90	- Djathra te tjera
04.07	0407.00	**Vezet e zogjve, ne guacke, te fresketa, te ruajtura apo te gatuara.**
04.08		**Vezet e zogjve, jo ne guacke, dhe te verdhat e vezeve, te fresketa, te thara, te gatuara ne avull apo nga zierja ne uje, te dhena forme, te ngrire apo te ruajtur ndryshe, nese permbajne apo jo sheqer shtese apo lende te tjera embelsuese shtese:**
		- Te verdhat e vezeve:
	0408.11	- - Te thara
	0408.19	- - Te tjera
		- Te tjera:

	0408.91	- - Te thara
	0408.99	- - Te tjera
04.09	0409.00	**Mjalte natyral.**
04.10	0410.00	**Produkte te ngrenshme me origjine prej kafsheve, te paperfshira dhe te paspecifikuara diku tjeter.**

KAPITULLI 5

PRODUKTET ME ORIGJINE PREJ KAFSHEVE, TE PAPERFSHIRA DHE TE PASPECIFIKUARA DIKU TJETER

Shenime

1. Ky Kapitull nuk perfshin:
   (a) Produktet e ngrenshme (perveç zorreve, fshikezat dhe stomaket e kafsheve, te tera apo pjese te tyre, dhe gjaku i kafsheve, leng apo i thare);
   (b) Lekuret e perpunuara (duke perfshire gezofet) ndryshe nga mallrat e kreut 05.05 dhe ndryshe nga prerjet dhe mbetjet e ngjashme te lekureve te paperpunuara te kreut 05.11 (Kapitulli 41 apo 43);
   (c) Materialet tekstile prej kafsheve, ndryshe nga floket e kalit dhe mbetjeve te flokeve te kalit (Seksioni XI); apo
   (d) Nyje apo xhufkat e pergatitura per berjen e furçave apo te fshesave (kreu 96.03).

2. Per qellimet e kreut 05.01, perzgjedhja e flokeve sipas gjatesise (me kusht qe fundet e rrenjeve dhe fundet e majave respektivisht nuk jane pershtatur se bashku) nuk do te konsiderohet si punim.

3. Gjate gjithe Nomenklatures, dhembet e elefantit, te hipopotamit, lopes se detit, te balenave te arktikut dhe te derrit te eger, briret e rinocerontit dhe dhembet e te gjitha kafsheve vleresohen si "fildish".

4. Gjate gjithe Nomenklatures, shprehja "floket e kalit" ka kuptimin e qimeve te krifes apo te bishtit te thundrakeve apo te gjedheve.

05.01	0501.00	**Floket e njerezve, te papunuara, nese jane apo jo te lara apo te pastruara; mbetje te flokeve te njerezve.**
05.02		**Qimet dhe kreshtat e derrave te bute, te derrave te eger; qimet e baldosave dhe qime te tjera per berjen e furcave; mbetjet e qimeve apo kreshtave te tille:**
	0502.10	- Qimet dhe kreshtat e derrave te bute dhe te derrave te eger sidhe mbetjet e tyre
	0502.90	- Te tjera
[05.03]		
05.04	0504.00	**Te brendshmet, fshikezat dhe stomaqet e kafsheve (perveç atyre te peshkut), te plota dhe pjese prej tyre, te fresketa, te ftohta, te ngrira, te kripura, ne uje me kripe, te thara apo te tymosura.**
05.05		**Lekuret e zogjve dhe pjese te tjera te zogjve, me puplat dhe pushin e tyre, puplat dhe pjeset e puplave (nese jane apo jo te zbukuruar ne anet) dhe pushi, jo me tej te punuara perveçse te pastruara, te disinfektuara apo te trajtuar ndryshe per ruajtje; pluhura dhe mbetje te puplave apo te pjeseve prej puplave :**
	0505.10	- Pupla te nje lloji te perdorur per mbushje; pushi
	0505.90	- Te tjera
05.06		**Kockat dhe palca e brireve, te papunuara, te cyndyrosura, thjesht te**

Seksioni I
Kapitulli 5

		pergatitura (por jo te prera ne forma), te trajtuara me acid apo te dexhelatinuara; pluhura dhe mbetje te ketyre produkteve:
	0506.10	- Oseine dhe kocka te trajtuara me acid
	0506.90	- Te tjera
05.07		**Fildish, guackat e breshkave, lapat e balenave dhe mustaqet e lapave te balenave, briret, thundrat, thonjte, kthetrat dhe sqepat, te papunuara apo thjesht te pergatitura por jo te prera ne forma; pluhuri dhe mbetjet e ketyre produkteve:**
	0507.10	- Fildish; pluhur fildishi dhe mbetje te tij
	0507.90	- Te tjera
05.08	0508.00	**Koralet dhe materialet e ngjashme, te papunuara apo thjesht te pergatitura por jo te punuar ndryshe; guackat e molusqeve, kafsheve guackore te nenujshme apo gjilperat e lekureve (psh te iriqeve) dhe kocka te tjera te tyre, te papunuara apo thjesht te pergatitur por jo te prere ne forma, pluhuri dhe mbetjet prej tyre.**
[05.09]		
05.10	0510.00	**Qelibar i hirte, kastori, zibet dhe myshku; cantharides; vreri, nese eshte apo jo i thare; gjendrat dhe produkte te tjera me origjine prej kafsheve te perdorur ne pergatitjen e produkteve farmaceutike, te fresketa, te ftohta, te ngrira apo te ruajtura ne menyra te tjera.**
05.11		**Produktet me origjine prej kafsheve te paperfshira dhe te paspecifikuara diku tjeter; kafshet e ngordhura te Kapitullit 1 apo 3, te papershtatshme per konsum njerezor:**
	0511.10	- Spermat e gjedheve meshkuj
		- Te tjera:
	0511.91	- - Produkte te peshkut apo te kafsheve guackore te nenujshme, molusqeve apo kafsheve te tjera jovertebrore ujore; kafshe te ngordhura te Kapitullit 3
	0511.99	- - Te tjera

SEKSIONI II

PRODUKTET VEGJETALE

Shenim

